



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 613 Prot.

Tiranë, më datë 21.04.2020

VENDIM

Nr. 127, datë 21.04.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.04.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Studim fizibiliteti për restaurimin, rindërtimin dhe rinovimin e sallës së koncerteve, në Universitetin e Arteve në Tiranë", kërkesë e Universitetit të Arteve;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI

**Elva
Margariti**

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.04.22
14:43:59 +02'00'